



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

Nr. 6. Prot.

Tiranë, më 05. 4. 2017

NJOFTIM PËR PARAQITJEN E APLIKIMEVE TË PROGRAMEVE/ MODULEVE TË TRAJNIMIT PËR PUNONJËSIT ARSIMORË NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PRANË KOMISIONIT TË AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit (KAPT) bazuar në udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhduar profesional të punonjësve arsimorë” dhe në dokumentin nr. 2988 prot, datë 24.03.2017 “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë, 2017-2020”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, njofton të gjitha agjencitë trajnuese dhe institucionet e arsimit të lartë që mbulojnë profilin e mësuesisë dhe që janë të interesuara për të organizuar trajnime me punonjësit arsimorë të sistemit parauniversitar, se **ka hapur procesin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit**. Tematika e programeve dhe moduleve të trajnimit duhet të jetë e fokusuar sipas **fushave dhe çështjeve kryesore** të paraqitura në dokumentin “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë, 2017 -2020”.

Agjencitë trajnuese/IAL-të duhet të paraqesin dosjen e aplikimit në formë zyrtare pranë sekretariatit të KAPT-it në Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA), në datat **27 prill, 28 prill dhe 2 maj 2017**.

Dosja e aplikimeve duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Emri i agjencisë trajnuese;
2. Të dhënat e kontaktit të agjencisë (adresa e postës elektronike, numri i celularit, linku i faqes së internetit të agjencisë, nëse ka);
3. Një kopje e noterizuar e dokumentit juridik të statusit të agjencisë (Statut, ekstrakt nga QKB-ja, Nipt, vendim gjykate, VKM etj. sipas formës së organizimit të agjencisë);
4. Tri kopje të formatit të plotëuar të aplikimit për secilin modul (shtojca 2);
5. CV-të e trajnerëve për çdo modul (Shtojca 3);
6. Listën e moduleve të akredituara më parë sipas viteve përkatëse
7. Numri i punonjësve arsimorë që ka trajnuar kjo agjenci për secilin prej moduleve të akredituar më parë (nëse ka).

Agjencitë që aplikojnë mbajnë përgjegjësi për plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të tyre. Për një informacion më të detajuar konsultoni legjislacionin përkatës të publikuar në faqen zyrtare të IZHA-s.

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet *drejtpërdrejtë pranë sekretariatit të KAT-it, që ndodhet në IZHA deri më datë 2 maj 2014, ora 14.00. Personi i kontaktit: Gentjana Marku (juriste),* Adresa: Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Rruga: Naim Frashëri nr. 37 , Tiranë, Tel: + 355 4 225 6440, Fax: + 355 4 225 6440, Web site: www.izha.edu.al

KRYETARI I KAPT

NORA MALAJ

